


Strategjia e Zhvillimit Vendor

Vizioni

Bashkë për një të ardhme dinamike dhe të begatë për zonën LEADER të GVV “Egnatia”!

Përmirësimi i cilësisë së jetës së banorëve në zonën “LEADER” të GVV “Egnatia” përmes promovimit të aktiviteteve sociale, arsimore, turistike dhe kulturore. Festa lokale, ekspozita, panaire, evente tradicionale, aktivitete sportive dhe krijimi i klubeve të rinisë do të mbështeten për të nxitur kohezionin mes banorëve dhe zhvillimin e qëndrueshëm socio-ekonomik të zonës “LEADER”.



Kontakt:

+355 69 728 8117

gvvegnatia24@gmail.com

Njësia Administrative Bradashesh, Elbasan, Shqipëri

GRUPI VENDOR I VEPRIMIT EGNATIA

**BASHKË PËR NJË TË ARDHME
DINAMIKE DHE TË BEGATË**



Rreth nesh

Zona “LEADER”

Grupi Vendor i Veprimit “Egnatia” vepron në territorin rural të Bashkisë Elbasan, duke përfshirë 12 njësitë administrative rurale të bashkisë Elbasan: Labinot-Fushë, Labinot-Mal, Gjinar, Shushicë, Gjergjan, Funar, Shirgjan, Tregan, Gracen, Bradashesh, Zavalinë dhe Papër dhe një njësi administrative të qytetit Elbasan. I gjithë ky territor ka profil rural dhe mbulon 116 fshatra dhe Lagjen nr 3 në qytetin e Elbasanit që përfshin zonën e ullishtes.

Zona “LEADER” e GVV “Egnatia” karakterizohet nga pasuri te shumta natyrore dhe potencial të madh në zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë në sajë të sipërfaqes të lartë të tokës bujqësore, pyjore dhe kullosore. Parqet kombëtare, trashëgimia e pasur kulturore dhe historike në zonë krijojnë kushtet e duhura për zhvillimin e turizmit të natyrës dhe të kulturës.

Popullsia

Në zonën “LEADER” të GVV “Egnatia” jetojnë rreth 110,871 banorë. Shpërndarja e popullsisë varion nga një njësi administrative në tjetrën, ku Bradasheshi është njësi administrative me numrin më të lartë të popullsisë, ndjekur nga Shushica dhe Shirgjan. Ndërsa njësitë me numrin

më të vogël të popullsisë janë Zavalina dhe Graceni. Përgjatë viteve të fundit ka patur dinamika të shumta përsa i përket ndryshimeve demografike të zonës. Disa njësi administrative kanë shënuar rritje të konsiderueshme si Bradashesh, Gjergjan, Labinot Fushë dhe Papëri, ndërkohë në disa njësi të tjera numri i popullsisë ka shënuar rënie si Funarë, Gjinar,

Historiku

GVV “Egnatia” u krijua në vitin 2023, falë mbështetjes së projektit “Fuqizimi i Grave në zonat Rurale dhe Turizmi”. GVV-ja filloi një proces intensiv të gjallërimit të territorit dhe mobilizimit të komunitetit për krijimin e partneritetit vendor dhe për hartimin e Strategjisë së Zhvillimit Vendor të zonës me pjesëmarrje dhe gjithëpërfshirëse, në frymën e parimeve të metodës “LEADER”.

I gjithë ky proces ishte në harmoni me Ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Grupeve Vendore të Veprimit”, me qëllimin për të kontribuar për një zhvillim të qëndrueshëm koheziv social ekonomik në komunitetet vendore të mbuluara nga zona “LEADER”. Në 2024, GVV Egnatia është e autorizuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për të funksionuar si Grup Vendor Veprimi – një strukturë partneriteti e lejueshme për mbështetje financiare nga programi i IPARD.

Struktura

GVV “Egnatia” është një strukturë partneriteti e aktorëve vendorë me përfaqësues nga tre sektorë (autoritete publike, operatorë ekonomik dhe social). Anëtarët e GVV përfaqësojnë gjithë territorin e zonës LEADER dhe grupet e interesit në zonë, duke respektuar barazinë territoriale, gjinore dhe të moshës.



Asambleja e Përgjithshme përbëhet prej 31 anëtarësh. Bordi përbëhet nga 9 anëtarë të zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme, ku secili prej sektorëve përfaqësohet nga 3 anëtarë. 3 anëtarë të Bordit janë gra, dhe 2 të rinj, poshtë moshës 35 vjeç. Të gjithë anëtarët e bordit janë rezidentë në territorin e GVV-së.